



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.106

2005

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9449 datë 15.12.2005	Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.2, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike”.....	3351
Ligj nr.9450 datë 15.12.2005	Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.3, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr.7971,datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar	3351
Ligj nr.9451 datë 15.12.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës, për projektin e ripërtëritjes së rrjetit elektrik të shpërndarjes, Fier”	3352
Ligj nr.9453 datë 15.12.2005	Për ratifikimin e “Protokollit nr.14 të Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, që ndryshon sistemin e kontrollit të Konventës”.....	3363
Vendim i ERRU nr.11, datë 22.12.2005	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, sh.a. ujësjellës Mat.....	3369
Vendim i ERRU nr.13, datë 24.12.2005	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik, sh.a. ujësjellës-kanalizime Lushnjë.....	3369
	Vendim i shkurtuar për kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetasit Guri Lara.....	3370

L I G J
Nr.9449, datë 15.12.2005

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR. 2, DATË 10.11.2005
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LEJIMIN E KESH SHA-SË TË MARRË PJESË NË
ANKANDET E BLERJES SË KAPACITETEVE TRANSMETUESE DHE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.2, datë 10.11.2005 i Këshillit të Ministrave “Për lejimin e KESH sh.a.-së të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike”.

**Shpallur me dekretin nr.4740, datë 6.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9450, datë 15.12.2005

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR. 3, DATË 23.11.2005
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7971, DATË
26.7.1995 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 23.11.2005 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.4741, datë 6.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9451, datë 15.12.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE INSTITUTIT TË KREDISË SHTETËRORE TË MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR PROJEKTIN E RIPËRTËRITJES SË RRJETIT ELEKTRIK TË SHPËRNDARJES, FIER”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës, për projektin e ripërtëritjes së rrjetit elektrik të shpërndarjes, Fier”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4742, datë 6.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJE E HUASË
NDËRMJET INSTITUTIT TË KREDISË SHTETËRORE TË MBRETËRISË SË SPANJËS DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ICO, që vepron në emër të Mbretërisë së Spanjës, me anë të kësaj, vendosin:

Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, me frymën e saj të lartë të miqësisë dhe të bashkëpunimit, të reflektuar në marrëdhëniet me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, i ka dhënë, në 26 nëntor 2004, vendit të sipërmendur një hua prej një shume deri në 9 304 464.66 (nëntë milionë e treqind e katër mijë e katërqind gjashtëdhjetë e katër, pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) dollarë në ngarkim të Fondo de Ayuda al Desarrollo (Fondi i Ndihmës për Zhvillim).

Kjo hua duhet të jetë një hua e përbërë nga pjesët e mëposhtme dhe duhet të aplikohet për të financuar 100% të mbështetjes zyrtare spanjolle të përcaktuar për rinovimin e rrjetit të shpërndarjes së enegjisë në Fier.

Një shumë minimale prej 8 677 371.89 (tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e një, pikë tetëdhjetë e nëntë) dollarë, e barabartë me 100% të mallrave dhe shërbimeve spanjolle, do të përdoret për financimin e mallrave dhe shërbimeve të eksportuara spanjolle.

Një shumë maksimale prej 8 043.69 (tetëmbëdhjetë mijë e dyzet e tre, pikë gjashtëdhjetë e nëntë) dollarë, e barabartë me 0.21% të mallrave dhe shërbimeve të eksportuara, do të financojë materialet e huaja.

Një shumë maksimale prej 609 049.08 (gjashtëqind e nëntë mijë e dyzet e nëntë, pikë tetë) dollarë, e barabartë me 7 % të mallrave dhe shërbimeve të eksportuara, do të financojë shpenzimet lokale.

Mbretëria e Spanjës, për implementimin e huasë së sipërpërmendur, po vepron nëpërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore si agjenti i saj financiar, sipas dispozitave të Këshillit të Ministrave të Spanjës, datë 26 nëntor 2004 dhe Republika e Shqipërisë po vepron nëpërmjet Ministrisë së

Financave, institucion i përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave datë_____.
Nënshkruesit këtu, në emër të qeverive përkatëse,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizimet

Llogaria e Marrëveshjes

I referohet llogarisë së hapur në emër të Ministrisë nga ICO-ja në librat e kontabilitetit të këtij të fundit me një bilanc fillestar prej 9 304 464.66 (nëntë milionë e treqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër, pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) dollarë, me qëllim regjistrimin e të gjitha transaksioneve në lidhje me Marrëveshjen. Duhet të kuptohet që referencat për llogarinë janë referenca për Llogarinë e Marrëveshjes.

Marrëveshja

I referohet Marrëveshjes së huasë, të nënshkruar nga Instituti i Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, për formalizimin e Huasë për të financuar transaksionet tregtare të sipërpërmendura. Duhet të kuptohet që referencat për Marrëveshjen janë referenca për Marrëveshja e Huasë.

Huamarrësi

I referohet Republikës së Shqipërisë, e cila sipas kësaj Marrëveshjeje vepron nëpërmjet Ministrisë për nënshkrimin dhe zbatimin e Marrëveshjes në fjalë. Kuptohet që referencat për Huamarrësin janë referenca për Republikën e Shqipërisë.

Ditë-punë

I referohen ditës në të cilën bankat tregtare janë të hapura dhe operative në Madrid, Nju-Jork dhe Tiranë.

CESCE

I referohet Agjencisë Spanjolle të Sigurimit të Kredisë për Eksport (Kompania Espanola de Seguros de Credito a la Explotacion).

Kodi

I referohet numrit sekret të dhënë nga ICO-ja. Kodi në fjalë do të shfaqet në krye të të gjitha aplikimeve, komunikimeve, njoftimeve dhe lajmërimeve të bëra me teleks ose fax, të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Nëse ICO-ja dhe Ministria kanë nënshkruar më parë ndonjë marrëveshje huaje të butë të Fondit të Ndihmës për Zhvillim, atëherë do të përdoret i njëjti kod.

Kontrata tregtare

I referohet kontratës së nënshkruar nga eksportuesit spanjollë dhe importuesit shqiptarë për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Monedha e rënë dakord dhe dollari amerikan

I referohet monedhës ligjore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në të cilën ICO-ja do të debitojë pagesat e bëra eksportuesve spanjollë në llogari, po ashtu do të kreditojë llogarinë në fjalë për shlyerjen e principalit dhe/ose pagesat e interesit dhe komisioneve të kryera nga Ministria.

ICO

I referohet Institutit të Kredisë Shtetërore, organizmi i caktuar nga Mbretëria e Spanjës për të vepruar si agjenti financiar i saj në përputhje me dispozitat e Kabinetit të Ministrave të Spanjës, datë 26 nëntor 2004, me qëllim nënshkrimin dhe zbatimin e Marrëveshjes.

KESH

Kompania Elektroenergjetike Shqiptare. Do të veprojë si agjenci zbatuese e projektit.

Huaja

I referohet shumës prej 9 304 464.66 (nëntë milionë e treqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër, pikë gjashtëdhjetë e gjashtë), të përcaktuar nga palët në Marrëveshje në përputhje me dispozitat e Kabinetit të Ministrave të Spanjës, datë 26 nëntor 2004, e cila mund të tërhiqet nga Huamarrësi nëpërmjet Ministrisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Ministria

I referohet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, e cila është caktuar nga

Republika e sipërpërmendur të veprojë në emër të saj për nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kuptohet që referenca për Ministrinë është referencë për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

Banka paguese

I referohet, në lidhje me këtë Marrëveshje, bankës së përcaktuar nga Huamarrësi dhe pranuar nga ICO-ja, nëpërmjet së cilës do të kryhen pagesat për eksportuesit spanjollë sipas kësaj Marrëveshjeje. Banka paguese, në përputhje me kontratën tregtare apo çdo lloj dokumenti që mund ta zëvendësojë atë, do të rishikojë dokumentet përkatëse, si dhe do të lëshojë vërtetimin e duhur në përputhje me shtojcën IV.

Autorizimi i pagesave

I referohet në lidhje me këtë Marrëveshje, urdhrin të parevokueshëm të lëshuar nga Ministria ose KESH-i nëse është autorizuar në mënyrën e duhur nga Ministria e Financave për ICO-në, me anë të të cilit kjo e fundit autorizohet të paguajë nëpërmjet bankës paguese shumat e detyrueshme ndaj eksportuesve spanjollë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën tregtare.

Neni 2

Kushtet për bërjen efektive të kësaj Marrëveshjeje

Marrëveshja në fjalë do të hyjë në fuqi, me kusht që ICO-ja të marrë dokumentet e përcaktuara më poshtë, në formën dhe përmbajtjen që ai e konsideron të kënaqshme.

Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me anë të të cilit miratohet kjo Marrëveshje.

Prokurën dhe depozitimet e nënshkrimeve të personave të autorizuar për të nënshkruar dhe zbatuar këtë Marrëveshje apo çfarëdo dokumenti tjetër që lidhet me të.

Ligjin me anë të të cilit Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar këtë Marrëveshje.

Opinionin ligjor të dhënë nga Ministria e Drejtësisë së Republikës të Shqipërisë, që vërteton përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe autorizimeve ligjore në lidhje me nënshkrimin dhe zbatimin e Marrëveshjes, të kërkuar nga rregullorja e brendshme ligjore e Huamarrësit.

ICO-ja, në formën e përcaktuar sipas nenit 19, duhet të njoftojë Ministrinë si për marrjen e të gjitha dokumenteve të përcaktuara më sipër, ashtu dhe për rezultatin e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje duhet të mbetet në fuqi derisa të gjitha angazhimet e lindura nga kjo përfundohen për të dyja palët.

Megjithatë, kjo Marrëveshje duhet të hyjë në fuqi brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga nënshkrimi i saj, e cila mund të shtyhet dhe për një periudhë tjetër prej gjashtë muajsh, me kërkesë të Ministrisë.

Neni 3

Shuma e huasë

1. Shuma e huasë vënë në dispozicion të Huamarrësit nëpërmjet Ministrisë, sipas Marrëveshjes në fjalë, është deri në një maksimum prej 9 304 464.66 (nëntë milionë e treqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër, pikë gjashtëdhjetë e gjashtë).

2. Për qëllime të paragrafit 1 më sipër, ICO-ja duhet të hapë në librat e tij të kontabilitetit llogarinë, me një shumë fillestare maksimale prej 9 304 464.66 (nëntë milionë e treqind e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër, pikë gjashtëdhjetë e gjashtë).

Ministria duhet të bëjë të gjitha regjistrimet në lidhje me këtë hua.

Neni 4

Alokimet e transaksioneve

Transaksionet e veçanta tregtare që do të financohen sipas kësaj huaje duhet të miratohen nga Ministria e Industrisë, Turizmit dhe Tregtisë së Spanjës sipas kërkesës nga Ministria apo KESH-i, nëse është autorizuar në mënyrën e duhur nga Ministri i Financës (shtojca V), përpara paraqitjes së kontratës tregtare ose, në mungesë të saj, të çdo dokumenti tjetër zëvendësues për të.

Kërkesa e sipërpërmendur duhet t'i bëhet ICO-së brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh

me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në mënyrën e përcaktuar në nenin 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe në përputhje me depozitimin e përcaktuar sipas shtojcës I të bashkëngjitur. Kjo periudhë mund të shtyhet nga ICO-ja.

ICO-ja duhet të njoftojë Ministrinë për miratimin nga Ministria e Industrisë, Turizmit dhe Tregtisë të Spanjës të transaksioneve të financuara nga kjo hua.

Me kryerjen e alokimit dhe miratimin e transaksionit tregtar të veçantë, sipas procedurave të vendosura për alokimin e transaksioneve, për çdo modifikim të kontratës tregtare, duhet të njoftohet ICO-ja.

Neni 5

Periudha e tërheqjeve

1. Periudha maksimale gjatë së cilës mund të aplikohen tërheqjet e huasë duhet të jetë 18 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Palët këtu, me anë të një marrëveshjeje të përbashkët, mund të shtyjnë këtë periudhë duke siguruar që apikimi të ICO-ja të jetë bërë 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së mbarimit të periudhës së tërheqjes, në formën e përcaktuar sipas nenit 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe në përputhje me shembullin e aplikimit të përcaktuar sipas shtojcës II, bashkëngjitur.

2. Pavarësisht përcaktimeve të bëra në paragrafin e mëparshëm, periudha e tërheqjes duhet të shtyhet automatikisht në datën e përcaktuar sipas kontratës tregtare ose, në mungesë të saj, sipas çdo dokumenti tjetër që mund t'i zëvendësojë ato, ICO-ja duhet të njoftojë Ministrinë mbi datën e shtyrë të përmendur më lart.

3. Ajo pjesë e huasë që mbetet e patërhequr pas periudhës së tërheqjes duhet të konsiderohet si e anuluar, pa ndikuar mbi përcaktimet e rëna dakord në nenin 15.

4. Me mbarimin e periudhës së tërheqjes, ICO-ja mund të aplikojë për tërheqje të reja nga huaja 20 (njëzet) ditë-punë pas mbarimit të kësaj periudhe, duke u siguruar që vërtetimi nga banka paguese është marrë përpara mbarimit të periudhës së tërheqjes.

Neni 6

Mekanizmat e tërheqjes

Tërheqjet nga huaja mund të kryen nëpërmjet një autorizimi pagese të parevokueshëm dhe unik të lëshuar nga Ministria ose KESH-i nëse është autorizuar në mënyrën e duhur nga Ministria e Financave (shtojca V) për ICO-në në formën e përcaktuar sipas nenit 19 (nëntëmbëdhjetë) dhe në përputhje me shtojcën II bashkëngjitur. Ministria do t'i dërgojë një kopje të autorizimit të pagesës bankës paguese.

Pagesat nga ICO-ja, në favor të eksportuesve spanjollë, do të kryhen vetëm nëpërmjet bankës paguese dhe pas bërjes së një njoftimi detyrues formal nga banka paguese në fjalë sipas kushteve të shtojcës IV, bashkëngjitur.

Autorizimi i pagesës, i përmendur më sipër, duhet të përmbajë:

- Emrin dhe adresën e eksportuesit spanjoll;
- Emrin dhe adresën e bankës paguese;
- Titullin sipas të cilit është bërë pagesa;
- Shumën e pagesës në monedhën e rënë dakord.

Përmbushja e autorizimit të pagesës nga ICO-ja sipas kësaj Marrëveshjeje është i pavarur nga kontrata tregtare. ICO-ja nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë mospërmbushje të kontratës tregtare. Në përputhje me këtë, Ministria merr përsipër t'i shlyejë ICO-së në dollarë shumën e paguar nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje.

ICO-ja do të jetë në gjendje të ndalojë çfarëdo tërheqjeje nëse Huamarrësi ka pagesa të pashlyera nga ana e tij në lidhje me principalin, interesin apo komisionet e lindura nga kjo Marrëveshje ose ndonjë marrëveshje tjetër e lidhur nga ICO-ja dhe Huamarrësi.

Në të njëjtën mënyrë, ICO-ja mund të ndalojë ndonjë tërheqje tjetër nga huatë e buta, në rast se një gjykatë kompetente do të ketë pranuar fillimin e procedurave ligjore përkatëse për zgjidhjen e çështjeve në lidhje me ndonjë praktikë që duhet eliminuar, të përmendur në nenin 15 pika 7.

ICO-ja duhet të njoftojë Ministrinë për debitimin e secilës tërheqje nga llogaria në monedhën e rënë dakord, si dhe për datën e saj.

Neni 7

Shumave të tërhequra sipas kësaj huaje do t'u llogaritet interesi në favor të ICO-së, që nga data e secilës tërheqje deri në datën përfundimtare të shlyerjes së tyre me një normë vjetore prej 0.3% (zero pikë tre për qind), të kërkueshme dhe të pagueshme çdo gjashtë muaj.

Në rastin e parapagesës së përcaktuar në nenin 10, interesi do të llogaritet vetëm mbi shumat e tërhequra dhe të paguara.

Interesi duhet të llogaritet duke marrë në konsideratë numrin e ditëve kalendarike që kanë kaluar dhe duhet të mbështetet në një vit prej 360 ditësh.

Neni 8

Komisionet

1. Komisioni i angazhimit

Mbi shumën e huasë së patërhequr gjatë periudhës së tërheqjes, përcaktuar në nenin 5, do të llogaritet një komision angazhimi prej 0.1% në vit, duke filluar tre muaj pas bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje deri në datën në të cilën shumat do të tërhiqen apo anulohen në përputhje me nenin 5 paragrafi 3.

Komisioni i angazhimit duhet të llogaritet duke konsideruar numrin e ditëve kalendarike që kanë kaluar aktualisht dhe duhet të mbështetet në një vit prej 360 ditësh.

2. Komisioni i menaxhimit

Një komision prej 0.1% do të zbatohet mbi shumën totale të huasë.

Neni 9

Shlyerja

Shuma totale e tërhequr nga huaja duhet të shlyhet nga Ministria për 35 vjet me një periudhë *grace* prej 12 vjetësh nëpërmjet 46 këstesh të barabarta gjashtëmujore. Kësti i parë do të paguhet 150 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Me mbarimin e periudhës së disponueshme apo me tërheqjen totale të huasë, ICO-ja duhet të përgatisë skedulin përkatës të shlyerjes dhe të njoftojë Ministrinë për miratimin e saj. Ministria duhet të bëjë çdo koment për të brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast mospërgjigjeje deri në përfundim të periudhës në fjalë, skeduli përkatës i shlyerjes do të konsiderohet i miratuar.

Ministria duhet të transferojë te ICO-ja çdo shumë të pagesave të kësteve në monedhën e rënë dakord, në datën e maturimit.

Neni 10

Parapagimi

Ministria mund të paguajë në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit, të gjithë apo një pjesë të çdo kësti të përcaktuar sipas nenit 9 më sipër, në mënyrë që pagesa të jetë një shumë minimale prej 100 000 dollarë, dhe shtesat janë shumëfisha të 10 000 dollarëve. Parapagesa të tilla do të kërkojnë llogaritjen e pagesave të mëparshme të pashlyera, si komisione dhe/ose interesa të pashlyera dhe do të zbatohen mbi principalin sipas rendit të kundërt të maturimit. ICO-ja duhet të lajmërohet 30 ditë përpara çdo parapagese.

Neni 11

Interesat e pashlyera në kohë

Nëse çdo shumë e kërkueshme dhe e pagueshme nga Ministria për ICO-në sipas kësaj Marrëveshjeje nuk është paguar në monedhën e rënë dakord, në datën e caktuar të pagesës, kjo shumë e papaguar do të mbledhë interesa në favor të ICO-së nga data e caktuar e pagesës deri në datën aktuale të pagesës me një normë interesi \$ libor 6-mujore, që do të zbatohet në datën e pagesës në fjalë, të marrë nga ICO-ja nga norma mesatare e Reuters's Screen plus 1% (një për qind).

Periodha e mosshlyerjes nuk do të zgjasë më tepër se 12 muaj. Përcaktimet e bëra në nenin 15 bëhen të zbatueshme pas kësaj.

Neni 12

Pagesa e interesave dhe komisioneve

Pagesa e interesit dhe e interesit të pashlyer në kohë, sipas neneve 7 dhe 19, do të kryhet në një periudhë 6-mujore derisa të jetë shlyer e gjithë huaja.

Megjithatë, datat e pagesave të interesit duhet të përputhen me datat e shlyerjes së principalit pas datës së parë të shlyerjes, në përputhje me nenin 9.

Komisioni i angazhimit, përcaktuar në nenin 8 më sipër, duhet të paguhet në të njëjtën datë të caktuar për interesin referuar paragrafit të mësipërm.

Komisioni i menaxhimit, përcaktuar me nenin 8, duhet të paguhet në datën e parë të pagesës së interesit në përputhje me nenin 13 paragrafi 3.

Ministria duhet të transferojë te ICO-ja shumat e përcaktuara si më sipër në monedhën e rënë dakord, në vlerën e datën e maturimit.

Neni 13

Vendi dhe data e pagesës

Pagesat e referuara në nenet 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 duhet të paguhet nga Ministria në monedhën e rënë dakord në llogarinë me nr.544-7-70783 të Bankës së Spanjës (Banco de Espana) në JP Morgan Chase Bank, të kreditohen në llogarinë me nr.21-000904-7 "Entes Publicos y Otros Organismos no Autonomos de la Administracion Central" (Entet Publike dhe Organizma të tjera jo Autome të Administratës Qendrore) në Bankën e Spanjës, Madrid, në favor Fondit të Ndihmës për Zhvillim (FAD).

Pagesa e parë e interesit dhe e komisionit të angazhimit, referuar në nenin 12, duhet të bëhet 6 muaj nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes. Pas datës së parë të shlyerjes, datat e pagesës së interesit duhet të përputhen me datat e shlyerjes së principalit.

Pagesa e komisionit të menxhimit, referuar në nenin e 12, duhet të kryhet në datën e pagesës së parë të interesit.

Nëse data e caktuar për pagesat e treguara në paragrafët e mësipërm bie në një ditë pushimi, këto pagesa do të kryhen menjëherë në ditën vijuese të punës.

Neni 14

Alokimi i pagesave

Shumat e marra nga ICO-ja si pagesa të lindura këtu, të çdo natyre, duhet të alokohen si vijon:

1. Për komisionet e kërkueshme dhe të papaguara;
2. Për interesat e pashlyera në kohë, nëse ka;
3. Për interesat e kërkueshme dhe të papaguara;
4. Për principalin e kërkueshëm dhe të papaguar.

Neni 15

Raste të mospërmbushjes

Ndodhja e një apo disa rrethanave vijuese do të mendohen si raste mospërmbushjeje:

Nëse, kur periodha referuar në nenin 11 paragrafi 2 ka përfunduar, Ministria nuk ka bërë shlyerjet e principalit ose pagesat e interesit apo të komisioneve sipas maturimit të tyre, në përputhje me kushtet e përcaktuara këtu.

Nëse, kur periodha referuar në nenin 11 paragrafi 2 ka përfunduar, Huamarrësi nuk ka paguar

ndonjë shumë të zotëruar si principal, interes apo komision, në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas çdo marrëveshjeje tjetër të nënshkruar nga ICO-ja dhe Huamarrësi.

Nëse Ministria dështon në nënshkrimin e Marrëveshjes për shkakun e përcaktuar këtu.

Nëse, për një arsye të paatribueshme ICO-së ndonjë nga transaksionet tregtare të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje është anuluar, tërësisht apo thelbësisht.

Nëse qeveria e Huamarrësit deklaron një moratorium të njëanshëm mbi pagesën e çdo borxhi tjetër të jashtëm në lidhje me sektorin publik dhe/ose të garantuar (financuar) nga CESCE-ja.

Nëse autoritetet e Huamarrësit modifikojnë në mënyrë të kundërt dhe thelbësore apo deklarojnë të pavlefshme ndonjë autorizim, miratim apo leje referuar në nenin 2.

Nëse, në lidhje me transaksionet e eksportit që do të financohen, veçanërisht në kontratën tregtare ka praktika të përfshira në rregullat e OECD-së për të eliminuar praktikën korruptive, veçanërisht ato të përfshira në Konventën e luftës kundër korrupsionit të zyrtarëve të huaj publikë në transaksionet ndërkombëtare të biznesit, të dhjetorit të vitit 1999 (që këtej e tutje Konventa e dhjetorit 1999).

Për këto qëllime, do të konsiderohet se ka paraktika për t'u eliminuar, kur një gjykatë kompetente deklaron ekzistencën e një faji në lidhje me këtë çështje.

Për rrjedhojë, ICO-ja pohon:

- që ai nuk ka dijeni, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, nëse ndonjë dhuratë ose pagesë, favor apo ndonjë lloj tjetër përfitimi, që mund të konsiderohet si një praktikë e eliminueshme nga Konventa e dhjetorit 1999, si nxitje për kontratën tregtare, mund të ketë ndodhur apo jo.

Në të njëjtën mënyrë, Huamarrësi pohon:

- që ai nuk ka dijeni, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, nëse ndonjë dhuratë ose pagesë, favor apo ndonjë lloj tjetër përfitimi, që mund të konsiderohet si një praktikë e eliminueshme nga Konventa e dhjetorit 1999, si nxitje për kontratën tregtare, mund të ketë ndodhur apo jo.

Nëse Ministria nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të Marrëveshjes në fjalë apo çdo detyrim tjetër të lidhur nga kjo Marrëveshje.

Neni 16

Shlyerjet e kërkuara

Në rastet e përcaktuara në nenin e mësipërm, ICO-ja, pas përfundimit të 30 ditëve nga data në të cilën i ka kërkuar Ministria të rregullojë situatën e saj:

a) Mund të kërkojë shlyerje të parakohshme të principalit të huasë, së bashku me pagesën e të gjitha interesave të llogaritura mbi të dhe çfarëdo shume tjetër që mund të kërkohej sipas kësaj Marrëveshjeje;

Nëse shlyerja e parakohshme ndodh për shkak të rrethanave të përcaktuara në nenin e 15 paragrafi 4, ICO-ja mund të kërkojë shlyerje të parakohshme vetëm për shumat e përdorura në lidhje me transaksionin e anuluar. Megjithatë, nëse Ministria aplikon për një alokim të ri nga ICO-ja dhe Ministria e Industrisë dhe Tregtisë së Spanjës e miraton këtë aplikim, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 4, ICO-ja mund t'i përdorë këto shuma për financimin e transaksioneve të tjera tregtare.

b) Mund të deklarojë angazhimet këtu të marra përsipër nga ICO-ja si të pavleshme nëpërmjet njoftimit të Ministrisë.

c) Në rastin kur ICO-ja nuk ka kërkuar shlyerjen e parakoshme të huasë dhe në një rast të tillë Huamarrësi ka siguruar garanci apo ndonjë formë tjetër të mbështetjes financiare për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të lindura nga transaksionet tregtare të financuara nga kjo Marrëveshje huaje, Huamarrësi është i detyruar të përdorë shumat e siguruar nga ekzekutimi i atyre garancive për shlyerjen e parakoshme të huasë.

d) Në rastet e përcaktuara në nenin 15 pika 7, ICO-ja mund të kërkojë shlyerjen e parakoshme të principalit të huasë, së bashku me pagesat e të gjitha interesave të llogaritura mbi të dhe çfarëdo shume tjetër që mund të kërkohej nëpërmjet vullnetit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Përgjegjësitë

Angazhimet e siguruara nga Huamarrësi këtu më poshtë renditen në mënyrë të barabartë dhe *pari passu* me çfardo borxhi tjetër të jashtëm të së njëjtës natyrë të Huamarrësit.

Në përputhje me këtë, çfarëdo preference apo prioriteti të vendosur nga Huamarrësi mbi ndonjë borxh tjetër të jashtëm të së njëjtës natyre do të jetë automatikisht i zbatueshëm mbi pjesën e ICO-së, pa ndonjë kërkesë paraprake.

Neni 18

Taksat dhe shpenzimet

Ministria duhet të bëjë të gjitha pagesat e lidhura nga këtu pa ndonjë zbritje për taksat, normat e interesit dhe shpenzime të tjera të çdo natyre të papaguara në vendin e saj dhe duhet të paguajë çdo kosto transferimi apo shkëmbimi të ndodhur në zbatim të kësaj.

Neni 19

Korrespondenca ndërmjet palëve

Të gjitha aplikimet, njoftimet, lajmet dhe komunikimet që duhet të dërgohen dhe bëhen nga palët sipas vullnetit të kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohen të pranuar në mënyrën e duhur kur të rezultojnë në formën e një letre të nënshkruar nga një person i veshur me fuqinë e duhur për të bërë këtë, në përputhje me nenin 2 paragrafi B ose në formën e një telex-i apo fax-i. Në rastin e telex-it mund të përdoret kodi i ICO-së.

Njoftimet apo komunikimet e dërguara në letër, telex ose fax duhet të jenë të detyrueshme për palët këtu dhe të konsideruara si të marra nga adresat për te adresat apo kodet e telex-it të përcaktuara më poshtë.

INSTITUTIT TË KREDISË SHTETËRORE
Paseo del Prado, 4
28014 Madrid,
TELEX: 42093 ICO E
FAX: (34) 91.592.17.00/91.592.17.85
PHONE: (34) 91.592.16.00/91.592.17.73

MINISTRISË SË FINANCAVE
Bul. Dëshmorët e Kombit
Tiranë
Albania
FAX: (355) 422.84.94
PHONE: (355) 422.84.05

KESH-it

Megjithatë, autorizimi i pagesës do të jetë i detyrueshëm kur ICO-ja të marrë dokumentet origjinale të firmosura siç duhet ose nëpërmjet letrës, telex-it apo fax-it. Në të njëjtën mënyrë, dokumentet e kërkuara në nenin 2 për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes duhet të jenë origjinale apo kopjet e tyre të njësuara me origjinalin.

Çdo ndryshim në adresën e ndonjëres prej palëve këtu nuk do të ketë efekt nëse nuk i është komunikuar palës tjetër siç është përcaktuar sipas këtij neni dhe nëse kjo e fundit nuk ka njoftuar se e mori njoftimin për këtë ndryshim.

Neni 20

Ligjet e zbatueshme

Kjo Marrëveshje ka një natyrë tregtare, subjekt i ligjit privat dhe duhet të drejtohet e interpretohet në përputhje me ligjin spanjoll. Për më tepër, palët këtu refuzojnë çdo ligj tjetër që mund të zbatohet ndaj tyre dhe duhet të vendosin nëpërmjet kodit të ligjeve dhe juridiksionit të gjykatave të Madridit për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje të lindur në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Zotimet

Në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe për sa kohë çdo angazhim i lindur nga kjo mbetet i papërmbyshur, Ministria ose KESH-i marrin përsipër të dërgojnë te ICO-ja dokumentet e përcaktuara më poshtë:

Një kopje të çdo dispozite të brendshme rregulluese, që kërkon një modifikim të emrit, strukturës dhe sistemit ligjor të Ministrisë apo KESH-it.

Njoftimin, të dhënë në përputhje me nenin 19 të Marrëveshjes, për çdo ndryshim të lindur në lidhje me personat, të cilët, në përputhje me nenin 2 pika b këtu, mund të jenë autorizuar për të nënshkruar dhe zbatuar këtë Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje është bërë dhe nënshkruar në katër kopje origjinale, dy në gjuhën spanjolle dhe dy në gjuhën angleze, të dyja njëloj të detyrueshme. Në rast konflikti, do të merret parasysh versioni spanjoll.

SHTOJCA I

Tiranë, _____

KËRKESË PËR ALOKIMIN E TRANSAKSIONEVE

Në përputhje me nenin 4 të Marrëveshjes së huasë të lidhur ndërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, të nënshkruar më _____, ne me anë të kësaj kërkojmë transaksionin tregtar të nënshkruar midis _____ të Spanjës (eksportuesi) _____ dhe _____ te (importuesi) sipas kontratës tregtare datë _____ për një shumë _____ (fjalët dhe shifrat) të financuara nga kjo hua.

Kredia që financon këtë transaksion tregtar është deri në një shumë prej _____ (fjalët dhe shifrat) dhe do të përdoret për të financuar _____% të finacimit zyrtar spanjoll.

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 4 të Marrëveshjes së huasë, është dërguar bashkëngjitur kontrata tregtare. Ne angazhohemi të komunikojmë çdo ndryshim të bërë kontratës tregtare.

Z. _____
(Personi i autorizuar)
(nënshkrimi, posti, vula)

SHTOJCA II

Tiranë, _____

APLIKIM PËR NJË SHTYRJE TË PERIUDHËS SË TËRHEQJES

Në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes së huasë, të lidhur ndërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, të nënshkruar më _____, ne me anë të kësaj dorëzojmë një aplikim formal për një shtyrje të periudhës së tërheqjes së huasë deri _____. Ne do të vlerësojmë marrjen e njoftimit nga ICO-ja për sigurimin e shtyrjes së mësipërme dhe datën në të cilën ajo do të hyjë në fuqi.

(Personi i autorizuar)
(Nënshkrimi i postit, vula)

SHTOJCA III

Tiranë, _____

AUTORIZIM PAGESE I PAREVOKUESHËM DHE UNIK

Në përputhje me nenin 6 pika 1 të Marrëveshjes së huasë, të lidhur ndërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria

e Financave, të nënshkruar më _____, ne me anë të kësaj ju autorizojmë të paguani në mënyrë të parevokueshme bankën _____ (banka paguese) në favor të eksportuesit spanjoll _____ adresa e të cilit është _____ shumën prej _____ (shuma totale në shifra dhe fjalë) në përputhje me kontratën tregtare, datë _____, përkundër certifikatës së lëshuar nga banka paguese sipas shtojcës IV, pasi kushtet e përcaktuara në kontratën tregtare të nënshkruar më _____ ndërmjet _____ dhe _____, me _____ të jenë përmbushur.

Si rrjedhojë, ne ju autorizojë që të debitori llogarinë në dollarë me shumën përkatëse sipas certifikatës vijuese të lëshuar nga _____ (banka paguese).

Përmbushja nga ICO-ja e udhëzimeve të përfshira në këtë autorizim pagese nuk sjell ndonjë përgjegjësi për ICO-në në përmbushjen dhe mospërmbushjen e kontratës tregtare apo çdo dokumenti tjetër që mund të zëvendësojë kontratën në fjalë, ose në kontroll të asaj dhe për të gjitha qëllimet që ICO-ja i konsideron si jo të detyrueshme nëpërmjet kësaj.

Në përputhje me këtë, Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave me anë të kësaj, merr përsipër të shlyejë ICO-në për shumën në dollarë të paguar sipas udhëzimeve tona në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e sipërpërmendur, pavarësisht rrethanave të lindura gjatë zbatimit të kontratës tregtare si para, ashtu dhe pas pagesës.

Z. _____
(Personi i autorizuar)
(Nënshkrimi, posti, vula)

SHTOJCA IV DËSHMIA E BANKËS PAGUESE

Marrëveshja e huasë e lidhur ndërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, datë _____, për një shumë prej _____

Ne, me anë të kësaj, në mënyrë solemne dhe të parevokueshme, vërtetojmë se pagesa që duhet t'i bëhet eksportuesit spanjoll (emri) _____ për një shumë prej _____ (fjalët dhe shifrat) mbështetur në autorizimin e pagesës, të lëshuar prej _____ është në përputhje me dispozitat e kontratës tregtare datë _____ të nënshkruar ndërmjet _____ dhe _____ të _____ prej një shume prej _____ (fjalët dhe shifrat).

Alternativa a) Në rastin kur nuk kërkohen dokumentet: atëherë nuk do të paraqiten dokumente nga eksportuesi spanjoll, në mënyrë që të kryhet pagesa në përputhje me kontratën tregtare.

Alternativa b) Në rastin kur nuk kërkohen dokumentet: atëherë dokumentet e paraqitura nga eksportuesi spanjoll që kanë të bëjnë me çështjet e eksportit janë të sakta dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën tregtare në fjalë.

Detajimi i kësaj pagese është si më poshtë:

_____ mallra dhe shërbime spanjolle
_____ materiale të huaja
_____ shpenzime lokale

Në vijim, ne vërtetojmë që, në përputhje me dokumentet që zotërojmë tani, shuma e tërhequr nga kredia tregtare është deri në _____.

Ne si bankë paguese marrim përsipër të autorizojmë ICO-në të auditojë në zyrën tonë çdo dokument në përputhje me kontratën tregtare.

Ju lutemi kryeni këtë pagesë në llogarinë tonë me numër _____ të hapur në _____.

Banka paguese

Shtojca IV do t'i dërgohet bankës paguese që të përdoret si model.

ANEKSI V

Dokumenti që autorizon KESH-in të nënshkruajë

Shtojca I, II dhe III

Marrëveshja e huasë e lidhur ndërmjet Institutit të Kredisë Shtetërore të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave datë_____.

Për qëllim të nenit 4 dhe 6 të Marrëveshjes së huasë, të dy këta persona, depozitimi i vërtetuar i nënshkrimit të të cilëve gjendet më poshtë, janë të autorizuar në emër të Huamarrësit të nënshkruajnë së bashku me shtojcat I,II dhe III të kësaj Marrëveshjeje.

Z._____
(Posti) _____
(Institucioni) _____

Nënshkrimi_____

Z._____
(Posti) _____
(Institucioni) _____

Nënshkrimi_____

Juaji singërisht,
Z._____
Ministër i Financave

L I G J

Nr.9453, datë 15.12.2005

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT NR.14 TË KONVENTËS “PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE”, QË NDRYSHON SISTEMIN E KONTROLLIT TË KONVENTËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli nr.14 i Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, që ndryshon sistemin e kontrollit të Konventës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4744, datë 6.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

PROTOKOLLI NR.14

I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVETHEMELORE QË NDRYSHON SISTEMIN E KONTROLLIT TË KONVENTËS

Preambul

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (që këtu do të quhet “Konventa”),

duke pasur parasysh rezolutën nr.1 dhe deklaratën e miratuar nga konferenca ndërministrorë europiane mbi të drejtat e njeriut, mbajtur në Romë më 3 dhe 4 nëntor 2000;

duke pasur parasysh deklaratat e miratuara nga Komiteti i Ministrave më 8 nëntor 2001, 7 nëntor 2002 dhe 15 maj 2003, në sesionin e tij, përkatësisht të 109-të, 111-të dhe 112-të;

duke ditur nevojën urgjente për ndryshimin e disa dispozitave të Konventës, me qëllim që të ruhet dhe përmirësohet efikasiteti i sistemit të kontrollit afatgjatë, kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të ngarkesës së punës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës;

duke ditur veçanërisht nevojën për të garantuar që Gjykata të vazhdojë të luajë rolin e saj të konsiderueshëm në ruajtjen e të drejtave të njeriut në Europë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Paragrafi 2 i nenit 22 të Konventës shfuqizohet.

Neni 2

Neni 23 i Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 23

Mandati dhe largimi nga detyra

1. Gjyqtarët zgjidhen për një afat prej nëntë vjetësh. Ata nuk mund të rizgjidhen.
2. Mandati i gjyqtarëve përfundon kur ata arrijnë moshën 70 vjeç.
3. Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë derisa të zëvendësohen. Megjithatë, ata vazhdojnë me shqyrtimin e çështjeve që kanë marrë në dorë.
4. Nuk mund të largohet nga detyra asnjë gjyqtar, nëse gjyqtarët e tjerë nuk vendosin me një shumicë prej dy të tretave se ai gjyqtar nuk ka përmbushur kushtet e caktuara.”

Neni 3

Neni 24 i Konventës shfuqizohet

Neni 4

Neni 25 i Konventës bëhet neni 24 dhe teksti i tij ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 24

Sekretaria dhe relatorët

1. Gjykata ka një sekretari, funksionet dhe rregullat e së cilës përcaktohen në rregulloren e Gjykatës.
2. Kur trupi gjykues përbëhet nga një gjyqtar, Gjykata asistohet nga relatorët që funksionojnë në autoritetin e kryetarit të Gjykatës. Ata janë pjesë e sekretarisë së Gjykatës.”

Neni 5

Neni 26 i Konventës bëhet neni 25 (“Gjykata me përbërje të plotë”) dhe teksti i saj ndryshohet si më poshtë:

1. Në fund të paragrafit d, presja zëvendësohet me pikëpresje dhe fjala “dhe” fshihet.
2. Në fund të paragrafit e, pika zëvendësohet me pikëpresje.
3. Shtohet një paragraf i ri f, i cili ka formulimin e mëposhtëm:
“f. Bën çdo kërkesë në pajtim me nenin 26 paragrafi 2.”

Neni 6

Neni 27 i Konventës bëhet neni 26 dhe teksti i tij ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 26

Trupi gjykues me një gjyqtar, komitetet, Dhomat dhe Dhoma e Lartë

1. Gjykata i shqyrton çështjet e sjella para saj në trup gjykues me një gjyqtar, në komitete me tre gjyqtarë, në Dhoma me shtatë gjyqtarë dhe në Dhomën e Lartë me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë. Dhomat e Gjykatës formojnë komitete për një periudhë të caktuar kohe.
2. Me kërkesë të Gjykatës në përbërje të plotë, Komiteti i Ministrave, me vendim unanim dhe për një periudhë të caktuar kohe, mund ta zbresin numrin e gjyqtarëve në Dhoma në pesë.
3. Kur është në një trup gjykues me një gjyqtar, gjyqtari nuk shqyrton asnjë kërkesë kundër Palës së Lartë Kontraktuese, në emër të së cilës ai është zgjedhur.
4. Gjyqtari që është zgjedhur në emër të Palës së Lartë Kontraktuese të interesuar merr pjesë si anëtar i Dhomës ose Dhomës së Lartë kryesisht. Nëse nuk ka të zgjedhur ose nëse gjyqtari nuk është në gjendje të marrë pjesë, në cilësinë e gjyqtarit merr pjesë një person i zgjedhur nga kryetari i Gjykatës nga një listë e dhënë paraprakisht nga ajo Palë.
5. Dhoma e Lartë ka në përbërje të saj edhe kryetarin e Gjykatës, zëvendëskryetarët, kryetarët e Dhomave ose gjyqtarë të tjerë të zgjedhur në pajtim me rregulloren e Gjykatës. Nëse në Dhomën e Lartë vjen një çështje në bazë të nenit 43, në Dhomën e Lartë nuk merr pjesë asnjë nga gjyqtarët e Dhomës që ka dhënë vendimin, me përjashtim të kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit që merrte pjesë në emër të Palës së lartë Kontraktuese të interesuar.

Neni 7

Pas nenit të ri 26, në Konventë shtohet edhe një nen i ri, që ka formulimin e mëposhtëm:

“Neni 27

Kompetenca e gjyqtarit të vetëm

1. Gjyqtari i vetëm mund ta deklarojë të papranueshëm ose ta heqë nga lista e çështjeve të Gjykatës një kërkesë të bërë në bazë të nenit 34, nëse një vendim i tillë mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm.
2. Vendimi është i formës së prerë.
3. Nëse një gjyqtar i vetëm nuk e deklaron një kërkesë të papranueshme ose e heq atë nga lista, gjyqtari ia paraqet atë një komiteti ose një Dhome për shqyrtim të mëtejshëm.”

Neni 8

Neni 28 i Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 28

Kompetenca e komiteve

1. Në lidhje me një kërkesë të bërë në bazë të nenit 34, një komitet, me votë unanime:
a) mund ta deklarojë atë të papranueshme ose ta heqë atë nga lista e çështjeve, nëse një

vendim i tillë mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm; ose

b) mund ta deklarojë atë të papranueshme dhe të nxjerrë në të njëjtën kohë një vendim mbi themelin e çështjes, nëse problemi i përfshirë në çështjen gjyqësore, përsa i takon interpretimit ose zbatimit të Konventës ose të protokolleve të saj, është një subjekt që ka gjetur zgjidhje në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

2. Vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare në bazë të paragrafit 1 janë të formës së prerë.

3. Nëse gjyqtari i zgjedhur në emër të një Pale të Lartë Kontraktuese të interesuar nuk është i komitetit, komiteti mund ta ftojë atë gjyqtar në çdo fazë të gjykimit të zërë vendin e një prej anëtarëve të komitetit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë edhe faktin nëse ajo Palë ka kundërshtuar zbatimin e procedurës në bazë të paragrafit 1.b.”

Neni 9

Neni 29 i Konventës ndryshohet si më poshtë:

1. Paragrafi 1 ndryshohet me formulimin e mëposhtëm: “Nëse nuk merret asnjë vendim në bazë të nenit 27 ose 28, ose në bazë të nenit 28, Dhoma vendos në lidhje me pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave individuale të bëra në bazë të nenit 34. Vendimi mbi pranueshmërinë mund të merret veçmas.”

2. Në fund të paragrafit 2 shtohet një fjali e re që ka formulimin e mëposhtëm: “Vendimi mbi pranueshmërinë merret veçmas përveç, kur gjykata, në raste të veçanta, vendos ndryshe.”.

3. Paragrafi 3 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 31 i Konventës ndryshohet si më poshtë:

1. Në fund të paragrafit a, fshihet fjala “dhe”.

2. Paragrafi b bëhet paragrafi c dhe shtohet një paragraf b me formulimin e mëposhtëm:

“b.Vendos për çështje që i vijnë Gjykatës nga Komiteti i Ministrave në pajtim me neni 46, paragrafi 4; dhe”.

Neni 11

Neni 32 i Konventës ndryshohet si më poshtë:

Në fund të paragrafit 1 shtohet një presje dhe numri 46 pas numrit 34.

Neni 12

Paragrafi 3 i nenit 35 të Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“3. Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të nenit 34 të papranueshme, kur mendon se:

a) kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollat e saj, haptazi e paarsyetuar ose abuzim i së drejtës për kërkesë individuale;

ose

b) paraqitësi i kërkesës nuk ka pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm, përveç kur respektimi i të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të Konventës dhe protokolleve të saj kërkon shqyrtimin e kërkesës në lidhje me themelin e saj, me kusht që për këtë shkak asnjë çështje të mos refuzohet nëse nuk është shqyrtuar si duhet nga një gjykatë kombëtare.

Neni 13

Shtohet një paragraf i ri 3 në fund të nenit 36 të Konventës, i cili ka formulimin e mëposhtëm:

“3.Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Europës mund të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seanca në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Lartë.”.

Neni 14

Neni 38 i Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 38

Shqyrtimi i çështjes

Gjykata e shqyrton çështjen së bashku me përfaqësuesit e palëve dhe, nëse është e nevojshme, ndërmerr një hetim, për kryerjen e efektshme të të cilit Palët e Larta Kontraktuese të interesuara ofrojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme.”

Neni 15

Neni 39 i Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 39

Zgjidhjet me pajtim

1. Në çdo fazë të gjyqimit, Gjykata mund të vihet në dispozicion të palëve të interesuara, me qëllim që të arrihet një zgjidhje me pajtim për çështjen mbi bazën e respektimit të të drejtave të njeriut sipas përcaktimit në Konventë dhe protokollet e saj.

2. Gjykimi i zhvilluar sipas paragrafit 1 është konfidencial.

3. Nëse arrihet një zgjidhje me pajtim, Gjykata e heq çështjen nga lista nëpërmjet një vendimi që kufizohet në një përmbledhje të shkurtër të themelit të çështjes dhe zgjidhjes së arritur.

4. Vendimi i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e kushteve të zgjidhjes me pajtim sipas përcaktimit në vendim.”

Neni 16

Vendimi i 46 i Konventës ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“Neni 46

Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t’ia referojë çështjen Gjykatës për t’u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t’i ketë dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në Komitet, ai mund t’ia referojë Gjykatës çështjen nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.

5. Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.”

Neni 17

Neni 59 i Konventës ndryshohet si më poshtë:

1. Futet një paragraf i ri 2, i cili ka formulimin e mëposhtëm:
“2. Bashkimi European mund të aderojë në këtë Konventë.”
2. Paragrafët 2, 3 dhe 4 bëhen përkatësisht paragrafët 3, 4 dhe 5.

Dispozita të fundit dhe transitore

Neni 18

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të Konventës, që mund ta shprehin pëlqimin e tyre për t’u detyruar nëpërmjet:

- a) nënshkrimit pa rezervën e ratifikimit, pranimi ose aprovimi; ose
- b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose aprovimi, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose aprovimi depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 19

Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës në të cilën të gjitha Palët në Konventë kanë shprehur pëlqimin e tyre për t’iu nënshtruar këtij protokoll në pajtim me dispozitat e nenit 18.

Neni 20

1. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokoll, dispozitat e tij zbatohen për të gjitha kërkesat që janë në shqyrtim e sipër në gjykatë, si dhe për të gjitha vendimet, ekzekutimi i të cilave është nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave.

2. Kriteri i ri i pranueshmërisë i prezantuar nëpërmjet nenit 12 të këtij protokoll në nenin 35, paragrafi 3.b të Konventës nuk zbatohet në lidhje me kërkesat e deklaruara të pranueshme para hyrjes në fuqi të këtij protokoll. Në dy vitet e para pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll, kriteri i ri i pranueshmërisë mund të zbatohet vetëm nga Dhomat dhe Dhoma e Lartë e Gjykatës.

Neni 21

Mandati i gjyqtarëve që kanë mandantin e parë në datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll zgjatet *ipso jure* deri në një afat total prej nëntë vjetësh. Gjyqtarët e tjerë përfundojnë mandatin e tyre, i cili zgjatet *ipso jure* me dy vjet.

Neni 22

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi;
- c) datën e hyrjes në fuqi të këtij protokoll në pajtim me nenin 19;
- d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që ka të bëjë me këtë protokoll.

Si dëshmi të kësaj të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 13 maj 2004, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëloj të vlefshme, në një kopje të vetme të cilat depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës.

VENDIM
Nr.11, datë 22.12.2005

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
SHA UJËSJELLËS MAT

Enti Rregullator i Sektorit të furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, i miraton:

Emri i subjektit	sh.a.ujësjellës Mat;
Zona nën juridiksion:	Qyteti Burrel me 4000 banorë dhe fshatrat me popullsi rreth 18 000 banorë.

Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:
Për ujin e pijshëm:

Konsumatori familjar:	23 lekë/m ³
Institucionet buxhetore:	60 lekë/m ³
Entet private:	80 lekë/m ³

Për kanalizimet:	
Konsumatori familjar:	2 lekë/m ³
Institucionet buxhetore:	4 lekë/m ³
Entet private:	6 lekë/m ³

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2006 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Vladimir Meksi

VENDIM
Nr.13, datë 24.12.2005

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
SHA UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJË

Komisioni Kombëtar i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, miraton:

Emri i subjektit:	sh.a. ujësjellës-kanalizime Lushnjë;
Zona nën juridiksion:	Rrethi Lushnjë, bashkia Lushnjë me 55 mijë banorë dhe fshatrat përreth me 16 mijë banorë.

Tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:
Për ujin e pijshëm:

Konsumatori familjar:	35 lekë/m ³
-----------------------	------------------------

Institucionet buxhetore:	70 lekë/m ³
Entet private:	95 lekë/m ³

Për ujërat e përdorura:	
Konsumatori familjar:	8 lekë/m ³
Institucionet buxhetore:	12 lekë/m ³
Entet private:	15 lekë/m ³

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.1.2006 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Vladimir Meksi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e rrethit gjyqësor Korçë me vendimin e saj nr.2436, datë 21.12.2005, vendosi kufizimin e zotësisë për të vepruar ndaj personit Guri Lara për të kryer veprime juridike, si dhe caktimin si kujdestar të motrës Athina Lara (Basko).

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 18.1.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë